



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr 1664/4 prot

Datë 17.09.2021

V E N D I M
Nr. 645/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.09.2021 me

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-98944-06-23-2021 me objekt “Blerje Artikuj Kancelari për Vitin 2021”, me fond limit 5,239,112 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ankimues: Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK
Adresa: Autostrada Tiranë – Durrës, km 8, Kashar, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK
Adresa: “Rruga e Barrikadave”, nr. 1/5, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Nenet 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.06.2021 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-98944-06-23-2021 me objekt “Blerje Artikuj Kancelari për Vitin 2021”, me fond limit 5,239,112 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.07.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

II.2. Në datën 07.09.2021 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1664/2 date 08.09.2021, lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 3262/19 prot., datë 14.09.2021 protokolluar me tonën me nr. 1664/3 prot., datë 15.09.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik vendimi i autoritetit kontraktor mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se komisioni i shqyrtimit të ankesës ka vendosur pranim pjesërisht të ankesës, si më poshtë vijon:

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit “Infosoft Office” SHPK, në pikat: 1, 3, 4, 5, 7, 8, 9, me argumentet e sipërcituara.*
2. *Të mos pranojë ankesën e operatorit “Infosoft Office” SHPK, në pikat: 2, 6, 10, me argumentet e sipërcituara.”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar shkresës nr. 3262/19 prot., datë 14.09.2021 të autoritetit kontraktor Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor rezulton se ankesa është pranuar pjesërisht, si më poshtë vijon;

1. *Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit “Infosoft Office” SHPK, në pikat: 1, 3, 4, 5, 7, 8, 9, me argumentet e sipërcituara.*
2. *Të mos pranojë ankesën e operatorit “Infosoft Office” SHPK, në pikat: 2, 6, 10, me argumentet e sipërcituara.”*

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 pika e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: 1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe

rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

- i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;
- ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ të vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, si dhe nga verifikimi i kryer pranë KPP, rezulton se operatori ekonomik i interesuar nuk ka paraqitur argumente sipas pikës 1 të nenit 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.6. Nga shqyrtimi i vendimit të komisionit të shqyrtimit të ankesës, KPP konstaton, se ky i fundit ka pranuar disa nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me mospërmbushjen e specifikimeve teknike për mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK. Komisioni gjykon se, me pranimin e disa pretendimeve të ngritura të operatorit ekonomik ankimues, autoriteti kontraktor duhet ta skualifikojë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK. Në këto kushte, Komisioni gjykon se pavarësisht pranimin pjesërisht të pretendimeve të ankimuesit nga KSHA, në thelb ky i fundit ka pranuar plotësisht objektin e ankesës të paraqitur, i cili është shfuqizimi i vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Europrinty Group” SHPK. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pas arsyetimit të KSHA, gjendja e operatorit ekonomik “Europrinty Group” SHPK do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 gërma “a” të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 115 pika 1 dhe 3 e ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-98944-06-23-2021 me objekt “Blerje Artikuj Kancelari për Vitin 2021”, me fond limit 5,239,112 lekë pa TVSH, zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK .

4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri